

Gjenden katër sera me drogë në Deçan, dyshohet se ishin të mbjellura rreth 300 bimë



29/07/2024 18:35

Policia e Kosovës në vazhden e angazhimeve të shtuara, gjatë implementimit të një plani operativ përmes pajisjeve teknologjike, në bjeshkën e Roshkodolit – Komuna e Deçanit në një zonë të thellë malore, kanë lokalizuar një vend ku dyshohej se po kultivoheshin bimë narkotike.

Me datë 29.07.2024 njësitet e specializuara kufitare së bashku edhe me njesinë e antidrogës, kanë shkuar në lokacionin e dyshuar, ku në vendin e ngjarjes janë gjetur 4 sera, në të cilat kishin qenë të mbjellura bimë të dyshuara narkotike të llojit marihuanë, të cilat dyshohet se ishin djegur nga persona të dyshuar.

Në bazë të shikimit të vendit të ngjarjes dyshohet se kanë qenë të mbjellura rreth 300 bimë narkotike të madhësisë nga/deri në 1-2m gjatësi.

Lidhur me rastin njësitë përkatëse në vendin e ngjarjes kanë marrë provat materiale si në vijim:

- Mostra të bimëve narkotike,
- Një (1) armë AK – 47 me 32 copë fishekë,
- Një (1) fishekë i kalibrit për armë të gjuetisë etj.

Provat materiale të bimëve narkotike që kanë mbetur të pa djegura, pas konsultimit me prokurorin përkatës janë asgjësuar në vendin e ngjarjes, ndërsa pas konsultimit me prokurorin kompetent është hapur rasti për veprat “Kultivim i bimëve narkotikëve” dhe “Posedim i paautorizuar i armëve dhe municioneve”.

Në lidhje me rastin meqenëse zona ndodhet afër kufirit, është komunikuar edhe Policia Kufitare e Republikës se Shqipërisë dhe ajo e Malit të Zi, të cilat kanë aktivizuar njësitet e tyre në zonat përkatëse të shteteve të tyre.

LAJME TË FUNDIT

Kuka: Akili e ka merituar medaljen olimpike, ndoshta edhe të artën


VV publikon të dhënat e një sondazhi të...

AKP shpalli rezultatet e shitjes së aseteve përmes likuidimit

“Nuk punojmë pa paga” – Pse Trepça po...

Më shumë nga uebi

nativeGRAM
by LuponMedia



Artikuj të ngjashëm

July 31, 2024

Kuka: Akili e ka merituar medaljen olimpike, ndoshta edhe të artën

July 31, 2024

VV publikon të dhënat e një sondazhi të INR-së: 55% e...

July 31, 2024

AKP shpalli rezultatet e shitjes së aseteve përmes likuidimit

July 31, 2024

“Nuk punojmë pa paga” – Pse Trepça po përballat sërish me...

July 31, 2024

Kurti thirrje për largimin e masave të BE-së ndaj Kosovës

July 31, 2024

Abdixhiku: Propozova 26 janarin – Zgjedhjet për LDK-në janë gjithmonë festë...